



SBASHK Arsimimi sot

Qershor, 2025

Gazeta elektronike

Në shenjë vlerësimi dhe respekti SBASHK degron në bregdet mbi 400 mësimdhënës, i viziton kryetari Rrahman Jasharaj



Në organizimin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), edhe këtë qershor ka nisur pushimi veror për mësimdhënësit-anëtar të Sindikatës, të cilët po nderohen nga SBASHK për përkushtimin, punën dhe kontributin e tyre shumvjeçar në arsimimin dhe edukimin e brezave. Gjatë qëndrimit të grupit të parë dhe të dytë të mësimdhënësve në bregdet, ata i vizitoi edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj: grupin e parë me 130 pushues që e... (faqe 7)

SBASHK merr pjesë në Konferencën Evropiane për Shëndetin Mendor dhe Rreziqet Psikosociale në Arsim



SBASHK edhe gjatë muajit qershor u përfaqësua në konferenca e aktivitete të ndryshme ndërkombëtare arsimore, përmes udhëheqësve të lartë të ... (faqe 8)

SBASHK pjesëmarrës në shumë tryeza arsimore ndërkombëtare



SBASHK në kuadër të angazhimit të vet për krijimin e kushteve sa më të mira... (faqe 2)

SBASHK ka vazhduar organizimin tradicional të pushimit të mbi 400 mësimdhënësve anëtarë të Sindikatës në bregdetin shqiptar



Në shenjë mirënjohje për punën e tyre dhe kontributin e gjatë në arsim, SBASHK në mënyrë simbolike u ka shprehur respektin mbi 437... (faqe 3)

SBASHK apelon te mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar: Mos nënshkruani kontrata të reja të punës



Ditët e fundit, në komunën e Vushtrisë është rishfaqur kërkesa për nënshkrimin e kontratave të reja të punës, pavarësisht se mësimdhënësit e Arsimit ... (faqe 10)



Editorial

SBASHK pjesëmarrës në shumë tryeza arsimore ndërkombëtare



SBASHK në kuadër të angazhimit të vet për krijimin e kushteve sa më të mira të punës për mësimdhënës dhe gjithë personelin arsimor në Kosovë, vazhdon të jetë i pranishëm edhe në tryeza arsimore të nivelit botëror duke shkëmbyer përvoja të ndryshme të cilat ndikojnë në zhvillimin profesional e didaktik. Kështu vetëm gjatë muajit qershor, SBASHK u përfaqësua nga Nënkyetarja znj. Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri në dy konferenca të ndryshme ndërkombëtare. Një ngjarje e veçantë ishte Konferenca e 113 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Kjo konferencë, që ëhtë një nga ngjarjet më të rëndësishme globale në fushën e punës dhe të drejtave të punëtorëve, ka mbledhur delegacione trepalëshe (qeveri, sindikata dhe përfaqësues të punëdhënësve) nga të gjitha

shtetet anëtare të ILO-së. Nënkyetarja Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, kishin përfaqësuar SBASHK-un në kuadër të delegacionit të Edukimit Ndërkombëtar (Education International – EI), duke qenë aktivë në seksionet që trajtojnë çështjet e arsimit dhe të punës, krahas përfaqësuesve sindikalistë nga mbarë bota. Kjo pjesëmarrje e SBASHK-ut në Konferencën e ILO-së ka një rëndësi të veçantë, pasi jo vetëm që siguron një zë për sindikalistët e arsimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, por gjithashtu dëshmon përkushtimin e SBASHK-ut për të ndjekur dhe ndikuar në zhvillimet globale që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve dhe standardet ndërkombëtare të punës. Duhet theksuar se pesë vite më parë, Kosova kishte delegacion zyrtar në këtë Konferencë, falë përfaqësimit nëpërmjet Këshillit Ekonomik-Social (KES). Sot, mungesa e këtij mekanizmi e ka lënë Kosovën jashtë tryezave të rëndësishme ndërkombëtare për dialog social dhe politikëbërje në fushën e punës. Kjo e bënë edhe më të vlefshme dhe të domosdoshme pjesëmarrjen e përfaqësuesve të SBASHK-ut, të cilët me angazhimin e tyre po mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e punëtorëve të arsimit të Kosovës në nivel ndërkombëtar.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

SBASHK edhe këtë vit e ka vazhduar organizimin tradicional të pushimit të mbi 400 mësimdhënësve anëtarë të Sindikatës në bregdetin shqiptar



Në shenjë mirënjohje për punën e tyre dhe kontributin e gjatë në arsim, SBASHK në mënyrë simbolike u ka shprehur respektin mbi 437 mësimdhënësve duke i dërguar për një pushim 5 ditor në bregdetin shqiptar në Durrës. Për t'u

kujdesur për gjithë organizimin dhe mbarëvajtjen e pushimit për qindra mësimdhënës nga të gjitha komunat e Kosovës, u angazhua Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, i përkrahur edhe nga stafi.

Për të treguar rrjedhën e gjithë organizimit të këtij pushimi, që nga vendimi i Këshillit Drejtues të SBASHK-ut për të realizuar pushimin e 437 mësimdhënësve së bashku me staf mbështetës e deri tek akomodimi dhe qëndrimi i mësimdhënësve në bregdet, mund të lexoni intervistën e realizuar me Sekretarin e Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.

SBASHK: Cili është qëllimi i këtij organizimi, tashmë tradicional të pushimit për mësimdhënës nga ana e SBASHK-ut?

Ymeri: Qëllimi kryesor i iniciativës së shkuarjes në deti të mësimdhënësve nën organizimin e SBASHK-ut, është mirënjohja e thellë e Sindikatës që ka për anëtarësinë e vet, derisa kjo është një nga mënyrat që SBASHK ka zgjedhur t'u shpreh këtë mirënjohje mësimdhënësve të cilët kanë kontribuar shumë në sistemin arsimor, meqë në këtë pushim të organizuar marrin pjesë kryesisht mësimdhënës para pensionit, dhe kjo është një mënyrë e shprehjes së respektit krahas edhe mirënjohjeve që SBASHK u jep mësimdhënësve me rastin e pensionimit.

SBASHK: Si është bërë përzgjedhja e mësimdhënësve për pushim?

Ymeri: Këshilli Drejtues i SBASHK-ut në mbledhjen e mbajtur më 1 mars 2025 ka marrë vendim për organizimin e pushimit për mësimdhënës-anëtar në bregdetin shqiptar, ku ka caktuar edhe disa kriterë mbi bazën e të cilave janë përzgjedhur mësimdhënësit. Si rregull i parë është që mësimdhënësit të jenë anëtar të SBASHK-ut aktualisht dhe së paku tri

vite paraprakisht. Po ashtu kriter tjetër është që të përzgjedhen mësimdhënësit të cilët nuk kanë qenë në vitet e fundit në bregdet nën organizimin e SBASHK-ut. Një nga kriteret e përzgjedhjes së pushuesve ka qenë edhe gjinia, ku është dashur të ketë balans në mes të numrit të pushuesve meshkuj dhe pushueseve femra ku 40 për qind e pushuesve është dashur të jenë të gjinisë femrore. Ndërsa numri i mësimdhënësve është caktuar me përqindje të anëtarësisë, ku është caktuar një në 45 anëtar të pushoj sivejt në bregdet nga anëtarësia e SBASHK-ut.

SBASHK: Sa janë ndarë të kënaqur mësimdhënësit me organizimin e këtij pushimi pa pagesë nga Sindikata?

Ymeri: Mësimdhënësit janë shprehur shumë të kënaqur me organizimin e SBASHK-ut, pasi është vetëm Sindikata e Arsimit ajo e cila i nderon vazhdimisht për kontributin shumë të çmuar në edukimin e brezave qoftë edhe me një pushim sikur ky në bregdetin shqiptar. Mësimdhënësit e kuptojnë që ky është një aktivitet simbolik i pushimit në bregdet, por që për ta paraqet edhe një vlerësim që u bëhet për punën e gjatë në arsim. Po ashtu, ky pushim i përvitshëm, nga mësimdhënësit shfrytëzohet edhe për njohje në mes vete dhe lidhjen e kontakteve të reja ndërsektoriale anë e kënd Kosovës. Gjatë takimeve dhe bashkëbisedimit me mësimdhënës, ata janë shprehur shumë të kënaqur me qëndrimin në bregdet, qoftë me pastërti të hotelit, plazh, ushqim por edhe përkujdesjen e stafit të SBASHK-ut, të cilën e kanë quajtur fenomenale. Disa mësimdhënës janë shprehur se po kalojnë momente shumë të këndshme, duke e quajtur atmosferën të bukur shoqërimin me kolegë. Po ashtu, gjatë bashkëbisedimeve me mësimdhënës, ata janë shprehur shumë falënderues dhe mirënjohës ndaj SBASHK-ut për vlerësimin që u është bërë, duke u shpërblyer në formë simbolike me një pushim gjashtëditor.

SBASHK: Cili është mesazhi që SBASHK dëshiron të përcjellë përmes këtij organizimi tradicional të pushimit për mësimdhënësit?

Ymeri: Ky organizim tashmë i përvitshëm nuk është thjesht një pushim, por një formë konkrete e vlerësimit dhe falënderimit për punën jetike që bëjnë mësimdhënësit në edukimin e brezave. Me këtë aktivitet, SBASHK përpiket të krijojë hapësira të merituarra qetësie dhe relaksimi për mësimdhënësit që kanë dhënë vite të tëra për arsimimin në Kosovë. Nuk ka fjalë që

mund ta përshkruajnë plotësisht ndjesinë kur sheh se këta mësimdhënës, shumë prej tyre afër pensionimit, marrin një frymë më lirshëm në praninë e natyrës dhe detit, ndihen të respektuar dhe të çmuar. Ky pushim gjithashtu bëhet urë lidhëse mes kolegëve nga komuna të ndryshme, duke sjellë miqësi, bashkëpunim dhe një ndjenjë të fortë komuniteti. Kjo është ajo që e bënë këtë

aktivitet të veçantë dhe e bënë SBASHK-un të vendosur që ai të vazhdojë çdo vit me përkushtim. Me këtë aktivitet tradicional, SBASHK jo vetëm që nderon dhe vlerëson punën e mësimdhënësve, por edhe forcon lidhjet e komunitetit arsimor, duke krijuar një hapësirë ku mirënjohja dhe bashkëpunimi ecin dorë për dorë.

TRAJNIMET

SBASHK vazhdoi aktivitetin sindikal në shërbim të anëtarësisë-organizoi 3 grupe të ndryshme të trajnimit



Në vazhden e angazhimeve për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për mësimdhënës-anëtar të SBASHK-ut, Sindikata ka vazhduar me ofrimin e trajnimeve pa pagesë për anëtarët e vet anë e kënd Kosovës. Edhe gjatë muajit qershor kanë vazhduar grupe të shumta të trajnimeve të cilat kishin filluar më parë, ku shumica u kurorëzuan edhe me testet përfundimtare dhe shpërndarjen e certifikatave për mësimdhënësit e suksesshëm në këto trajnime.



Të mërkurën e 25 qershorit SBASHK filloi me dy grupe të trajnimit në Prishtinë në programin “Aplikimi i Programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerët e përzgjedhur: Arben Zymeri dhe Blerona Ahmeti. Mësimdhënësit të cilët e filluan trajnimin i vizitoi edhe kryetari i SKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini, i cili u shprehu përkushtimin e madh për krijimin e kushteve sa më të mira për mësimdhënësit të cilët janë interesuar për t'i ndjekur këto trajnime. Ditë më parë, një grup i trajnimit kishte filluar edhe në Vushtrri në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajner Zahir Kastrati.



Ndërkohë, gjatë muajit qershor janë organizuar edhe një numër testesh për mësimdhënësit të cilët e kanë përfunduar me sukses trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku testi është pjesë përfundimtare e trajnimit.



Në Pejë, më 15 qershor u mbajt testi për një grup të mësimdhënësve të cilët e kishin ndjekur këtë trajnim, derisa u administrua nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri.



Gjatë testimit të mësimdhënësve, i pranishëm ishte edhe kryetari i SKAP-it për Pejë, Isuf Lajqi si dhe trajneri që udhëhoqi këtë grup, Burim Krasniqi.


Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



Po ashtu, në të njëjtën ditë test u organizua edhe në Viti për një grup të mësimeve të cilët e kishin ndjekur trajnimin nën udhëheqjen e trajnerit Musli Neziri.



Testi u administrua nga Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti. Ndërkohë, për ta përcjellur mbarëvajtjen e trajnimit, i pranishëm ishte edhe kryetari i SKAP-it për Viti, Kemajl Bislimi.



Të dielën e 15 qershorit, po ashtu Kryesia e SBASHK-ut mbajti një mbledhje online nën udhëheqjen e Kryetarit Rrahman Jasharaj, ku u bisedua për aktivitetet e SBASHK-ut, për përgatitjet për pushime dhe u morën disa vendime.



Gjatë gjysmës së parë të qershorit, ishin organizuar testet edhe për dy grupe të mësimeve të cilët e kishin përfunduar më parë trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime në Malishevë dhe në Klinë. Në Malishevë testi u administrua nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, derisa i pranishëm ishte edhe kryetari i SKAP-it për këtë komunë, Skender Gashi.




Kurse trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Albert Samadaxha.



Edhe në Klinë ishte testuar një grup i mësimeve të cilët e kishin ndjekur po të njëjtin trajnim, derisa trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Nexhmedin Gruda e kishte udhëhequr këtë grup të trajnimit.



Edhe në Klinë i pranishëm ishte kryetari i SKAP-it, Arif Elezaj kurse testi u administrua nga Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës



Ndërkohë, qysh në javën e parë të qershorit ishin mbajtur testet edhe për tri grupe tjera të mësimdhënësve, në Fushë-Kosovë, Obiliq e Shtime.



Të dielën e 8 qershorit u mbajtën testet për dy grupe të mësimdhënësve të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Fushë-Kosovë dhe Obiliq.



Testet u administruan nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, derisa trajnimet ishin udhëhequr nga trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Blerona Ahmeti, respektivisht Xhelal Krasniqi.



Një ditë më parë ishte mbajtur testi edhe për mësimdhënësit e Shtimes, nën udhëheqjen e Sekretarit të Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, derisa i pranishëm ishte edhe trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Ferid Shaqiri.



PUSHIMET NË BREGDET

Në shenjë vlerësimi dhe respekti SBASHK degron në bregdet mbi 400 mësimdhënës, i vitin kryetari Rahman Jasharaj



Në organizimin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), edhe këtë qershor ka nisur pushimi veror për mësimdhënësit-anëtar të Sindikatës, të cilët po nderohen nga SBASHK për përkushtimin, punën dhe kontributin e tyre shumvjeçar në arsimimin dhe edukimin e brezave. Gjatë qëndrimit të grupit të parë dhe të dytë të mësimdhënësve në bregdet, ata i vizitoi edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj: grupin e parë me 130 pushues që e përfundoi pushimin gjashtëditor dhe grupin e dytë me gjithsej 104 pjesëmarrës të cilët sapo e kishin filluar pushimin e tyre.



Në të dy takimet, z. Jasharaj pati mundësinë të bisedojë nga afër me pushuesit. Ata të grupit të parë u shprehën shumë mirënjohës për organizimin e shkëlqyer dhe për kujdesin që SBASHK-u po vazhdon të tregojë ndaj anëtarëve të vet. Kurse mësimdhënësve të grupit të dytë, z. Jasharaj u uroi pushime të mbara, plot relaks dhe përjetime të këndshme gjatë gjithë qëndrimit të tyre. Gjatë gjithë vizitës, Kryetari Jasharaj u shoqërua nga Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, i cili po kujdesej që çdo detaj i pushimeve të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Këto pushime janë dëshmi e përkushtimit të SBASHK-ut për të



shpërblyer punën dhe angazhimin e mësimdhënësve, duke u krijuar atyre mundësi për relaks dhe rifreskim pas një viti të ngarkuar pune. Organizimi i tyre është një tjetër konfirmim se SBASHK-u është gjithmonë pranë anëtarëve të vet — jo vetëm në mbrojtjen e të drejtave të tyre, por edhe në kujdesin për mirëqenien dhe jetën e tyre.



Ky aktivitet, i cili ka filluar me grupin e parë prej 130 pushuesve, grupin e dytë prej 104 pushuesve, ka vazhduar edhe me grupin e tretë dhe të fundit prej 210 mësimdhënësve të cilët kanë qëndruar në bregdetin shqiptar gjatë verës 2025.

Sikurse çdo vit, edhe këtë herë SBASHK ka përfshirë në këtë aktivitet anëtarë nga mbarë vendi, përfshirë edhe katër bashkëkombës nga Bujanoci. Pushimi ka zgjatur gjashtë ditë. Derisa përzgjedhja e pjesëmarrësve është bërë nga shoqatat sindikale në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut.



UDHËTIMET JASHTË VENDIT

SBASHK merr pjesë në Konferencën Evropiane për Shëndetin Mendor dhe Rreziqet Psikosociale në Arsim



SBASHK edhe gjatë muajit qershor u përfaqësua në konferenca e aktivitete të ndryshme ndërkombëtare arsimore, përmes udhëheqësve të lartë të Sindikatës. Më 17-18 qershor 2025 në Bruksel ku u mbajt Konferenca e Partnerëve Social Evropian me temën “Shëndeti mendor në punë dhe rreziqet psikosociale në arsim”, e organizuar nga ETUCE dhe EFEE, SBASHK u përfaqësua nga Nënkryetaria, znj. Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri. Kjo konferencë ishte si përmbyllje e një pune dyvjeçare, që përfshiu edhe një hulumtim të gjerë mbi mirëqenien në vendin e punës në sektorin e arsimit, pas ndikimeve të pandemisë COVID-19.



Përgjatë dy ditëve, sindikatat e arsimit dhe punëdhënësit u mbledhën për konferencën përfundimtare të projektit APRES COVID, të bashkëorganizuar nga ETUCE dhe EFEE. Nën temën “Shëndeti Mendor në Punë dhe Rreziqet Psikosociale në Arsim”, eventit dy-ditor mbledhi së bashku palët e interesuara të arsimit, studiuesit, politikëbërësit e BE-së dhe edukatorët për të eksploruar se si dialogu social mund të nxisë përmirësime sistemike në kushtet e punës dhe shëndetin mendor të mësuesve, akademikëve dhe stafit të arsimit në të gjitha nivelet e arsimit.



Z. Jelmer Evers, Drejtor i ETUCE, dhe z. Paddy Lavelle, Zëvendës-president i EFEE, hapën konferencën duke theksuar rëndësinë e rreziqeve psikosociale në punën e përbashkët të dialogut social evropian në arsim, mes kompleksiteteve në rritje shoqërore dhe në klasë dhe pritjeve në rritje mbi sektorin e arsimit dhe edukatorët. Konferenca ofroi një platformë për të ndarë njohuritë kërkimore, praktikat kombëtare dhe strategjitë e përbashkëta për të siguruar mjedise arsimore të sigurta, mbështetëse dhe të shëndetshme.



Gjatë gjithë aktivitetit dy-ditor, pjesëmarrësit shqyrtuan ndërveprimin midis kushteve të punës dhe mirëqenies në punë, implikimet e dixhitalizimit dhe inteligjencës artificiale, si dhe strategjitë për të luftuar dhunën dhe ngacmimin në mjediset arsimore. Konferenca përfundoi me një diskutim në panel me vizion, duke riafirmuar angazhimin e partnerëve socialë evropianë për të vazhduar avokimin për mjedise pune të denja, të shëndetshme dhe të qëndrueshme në arsim.

SBASHK pjesëmarrës në Konferencën e 113-të Ndërkombëtare të Punës të ILO-së në Gjenevë



Në fillim të muajit qershor SBASHK ishte përfaqësuar edhe në Gjenevë në Konferencën e 113-të Ndërkombëtare të Punës, të organizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO).



Kjo konferencë përbënë një nga ngjarjet më të rëndësishme globale në fushën e punës dhe të drejtave të punëtorëve, duke mbledhur delegacione trepalëshe (qeveri, sindikata dhe përfaqësues të punëdhënësve) nga të gjitha shtetet anëtare të ILO-së. Megjithatë Kosova aktualisht nuk është pjesë zyrtare e kësaj Konference për shkak të mosfunksionimit të Këshillit Ekonomik-Social (KES), përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare.

Nën kryetarja Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, kishin përfaqësuar SBASHK-un në kuadër të delegacionit të Edukimit Ndërkombëtar (Education International – EI), duke qenë aktivë në seksionet që trajtojnë çështjet e arsimit dhe të punës, krahas përfaqësuesve sindikalistë nga mbarë bota.

Kjo pjesëmarrje e SBASHK-ut në Konferencën e ILO-së ka një rëndësi të veçantë, pasi jo vetëm që siguron një zë për sindikalistët e arsimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, por gjithashtu dëshmon përkushtimin e SBASHK-ut për të ndjekur dhe ndikuar në zhvillimet globale që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve dhe standardet ndërkombëtare të punës. Duhet theksuar se pesë vite më parë, Kosova kishte delegacion zyrtar në

këtë Konferencë, falë përfaqësimit nëpërmjet Këshillit Ekonomik-Social (KES). Sot, mungesa e këtij mekanizmi e ka lënë Kosovën jashtë tryezave të rëndësishme ndërkombëtare për dialog social dhe politikëbërje në fushën e punës. Kjo e bënë edhe më të vlefshme dhe të domosdoshme pjesëmarrjen alternative të përfaqësuesve të SBASHK-ut, të cilët me angazhimin e tyre po mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e punëtorëve të arsimit të Kosovës në nivel ndërkombëtar.



U mbajtën zgjedhjet Sindikale në Podujevë – kryetar u rizgjodh Fadil Halimi, kurse nënkryetare Elfate Seta



Të shtunën e 14 qershor në Podujevë u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Sindikatës Komunale të Arsimit Parauniversitar (SKAP), ku u zgjodh kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e SKAP-it të Podujevës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në Podujevë, të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e lartë të SBASHK-ut: Nënkryetarja znj. Vjollca Shala dhe zyrtari ligjor, z. Blendor Shatri.



Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta ku në vitin 2025 po mbahen zgjedhjet për të gjitha shoqatat sindikale dhe për nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut. Këshilli Drejtues kishte shpallur këtë vit si vit zgjedhor që në fillim të vitit kalendarik. Procesi zgjedhor në Podujevë u zhvillua në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë.



Kryetar i SKAP-it për Podujevë u rizgjodh Fadil Halimi kurse nënkryetare, Elfate Seta.

SBASHK apelon te mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar: Mos nënshkruani kontrata të reja të punës

Ditët e fundit, në komunën e Vushtrisë është rishfaqur kërkesa për nënshkrimin e kontratave të reja të punës, pavarësisht se mësimdhënësit e Arsimit Parauniversitar tashmë kanë kontrata pune me afat të pacaktuar.

Versioni i Kontratës së re është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 10/2015, që është në fuqi dhe dhe ka më pak të drejta të precizuara, krahasur me Kontratat që kanë punëtorët e Arsimit Parauniversitar.

SBASHK kërkon nga komuna e Vushtrisë që menjëherë të ndalë këtë praktikë të gabuar dhe presionin ndaj mësimdhënësve, si dhe u bën thirrje të gjitha komunave tjera që të mos ndjekin këtë shembull të dëmshëm, i cili bie ndesh me të drejtat e garantuara të punëtorëve.

Njëkohësisht, apelojmë te të gjithë anëtarët tanë, që kanë kontrata me afat të pacaktuar, të mos nënshkruajnë këto versione të reja të kontratave, edhe në rast se ndihen të presionuar nga punëdhënësit.

Kujtojmë se çdo formë presioni për nënshkrim kontrate

të pafavorshme përbën shkelje të Kodit të Punës (Ligji Nr. 03/L-212), e cila mund të sjellë pasoja ligjore për punëdhënësin. Çdo rast i tillë mund dhe duhet të raportohen në SBASHK për trajtim institucional.



